



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1203/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29.02.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



01/Nr.1178/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 12.2 (d), 17 (b) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), Ligji për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme Nr.03/L-139 neni 4 pika 2.4 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009), Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 11, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PRONAVE TË PALUAJTSHME

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave si në vijim:

Parcela me numër P-73317036-00366-4 në sipërfaqe 305 m², me kulturë Arë e Klasës 5.
Parcela me numër P-73317036-00365-4 në sipërfaqe 165 m² me kulturë Arë e Klasës 5.
Parcela me numër P-73317036-00448-2 në sipërfaqe 194 m² me kulturë Arë e Klasës 5.
Parcela me numër P-73317036-00448-3 në sipërfaqe 7 m² me kulturë Arë e Klasës 5.

Të gjitha së bashku në sipërfaqe 671 m² zona kadastrale Hani i Elezit në pronësi të Guri i Bekuar sh.p.k.

Parcela me numër P-73317036-00371-0 në sipërfaqe 167 m² Arë e Klasës 5 zona kadastrale Hani i Elezit në pronësi të z.Mevludin Zylfi Kuka.

Parcela me numër P-73317079-01204-37 në sipërfaqe 340 m² zona kadastrale Seçishtë në pronësi të z.Xhemshi Kadri Luri.

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave të lartshënuar është 1178 m² janë prona private dhe mbi këto parcela është paraparë Asfaltimi i rrugës Eksodi 99 –Hani i Elezit (rruga e cila shpie te Kompleksi Memorial Bllaca -99).

2. Duke ju referuar nenit 1 të këtij vendimi, ekzekutimin e mëtutjeshëm të shpronësimit do ta kryen ekzekutivi i komunës sipas procedurave ligjore .

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkiviti i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 29.02.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta